

VENDIM
Nr. 997, datë 8.11.2013

**PËR LEJIMIN E MUZEUT KOMBËTAR TË ARTIT MESJETAR, KORÇË, PËR VAZHDIMIN
E KRYERJES SË PROCEDURËS SË PROKURIMIT PUBLIK PËR SHËRBIMIN ME ROJE
CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimin nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, Korçë, të vazhdojë kryerjen e procedurës së prokurimit publik, me fond limit 387 000 (treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë, pa TVSH, për shërbimin me roje civile, me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama